

CV-ja

Ferat Shala

Ka lindur në Vuçak të komunës së Drenasit, më 10 qershor të vitit 1964. Shkollën fillore e ka mbaruar në vendlindje, ndërkaq të mesmen në Drenas. Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë, drejtimi i Gjeologjisë, e ka mbaruar në Mitrovicë, në vitin 1991. Në vitin 2006 ka magjistruar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës. Në mars të vitit 2013 ka doktoruar në Universitetin “Goce Delçev” të Shtipit (Maqedoni). Është doktor i shkencave teknike. Ferat Shala është profesor i asociuar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë. Më parë ka dhënë mësim në Fakultetin e Gjeoshkencave në Mitrovicë dhe kolegjin universitar Tempulli. Ai po ashtu, ka qenë dhe vazhdon të jetë konsulent profesional i disa kompanive që merren me ndërtime dhe miniera. Për afër katër vjet (dhjetor 2008 – korrik 2012), ka drejtuar ndërmarrjen Trepça. Ka botuar me dhjetëra punime shkencore nëpër revista shkencore prestigjioze të vendit dhe botës, si: Shqipëri, Itali, Slloveni, Gjermani, Britani e Madhe, SHBA, Turqi, Austri etj. Ai, po ashtu me punime shkencore ka marrë pjesë nëpër konferenca, seminare dhe forume shkencore, në shumë vende të ndryshme të botës. Ka qenë Minister dhe Zv.ministër në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Aktualisht është deputet i Kuvendit të Kosovës i zgjedhur për të dytën herë radhazi dhe njëherit Udhëheqës i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti të Kuvendit të Kosovës.